

SHABAN DEMIRAJ

RRETH FORMAVET TË SË ARDHMES NË GJUHËN SHQIPE

Është tashmë një fakt i njohur që në gjuhën e sotme shqipe, për të shprehur kuptimin e kohës së ardhme, përdoren kryesisht¹ dy tipa formash analitike, që ndërtohen me anë të pjesëzës foljore «do» dhe me anë të foljes «kam». Në tipin e parë pjesëza «do» ndiqet nga e tashmja e lidhore, të pajisur ose jo me pjesëzën të (*do të bëj, do bëj*).

Në tipin e dytë kemi këto tri formime: 1) *kam* + paskajorja e tipit *me ba*; 2) *kam* + forma e pashtjellë e tipit *për të bërë* me vlerë paskajoreje; 3) *kam* + e tashmja e lidhore.

Duke u mbështetur në gjuhën e veprës së Buzukut, M. La Piana (Studi linguistici albanesi, I, 1939, f. 150), dhe pas tij I. Ajeti (Nji shqyrtim i shkurtë mbi zhvillimin e futurit në shqipe, «Jeta e Re» 2, 1954, 122) dhe M. Domi (Morfologjia historike e shqipes — konspekt leksione, 1961, f. 70) kanë pranuar që në një fazë më të vjetër shqipja përdorte edhe të tashmen e lidhore me vlerën e kohës së ardhme. Përdorimin e së tashmes së lidhore me vlerën e së ardhmes, duke u mbështetur edhe në gjuhën e Buzukut, e ka vënë në dukje edhe K. Cipua (Gramatika shqipe, 1949, f. 116).

* * *

Për sa i takon tipit të së ardhmes me pjesëzën foljore «do», siç dihet, në gjuhën shqipe (sidomos në të folmet jugore), përveç formës së tipit *do të bëj*, përdoren edhe format e tipit a) *do të bëja / do bëja*, me vlerën e së ardhmes në të shkuarën, përkatësisht të mënyrës kushtore²; b) *do të kem bërë / do kem bërë*, e cila përdoret kryesisht me vlerën e një *modus praesumptivus* për të shprehur veprime ose gjendje të mundshme të së shkuarës³ dhe jashtëzakonisht rrallë me vlerën e një

1) Për përdorimin e së tashmes së dëftores dhe të lidhore me vlerën e së ardhmes do të bëhet fjalë më poshtë.

2) Shih për këtë Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë) II/215; F. Agalliu, *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, «Studime filologjike» 2, 1968, 134.

Të kihet parasysh se identiteti formal i së ardhmes në të shkuarën me mënyrën kushtore e ka burimin në faktin se kjo e fundit është përfutur nëpërmjet përdorimit të së parës nëpër apodosa periudhash hipotetike.

3) Me këtë vlerë kjo formë haset edhe në disa të folme geqe; shih për këtë G. Shkurtaj, *E folmja e Kastratit*, «Studime filologjike» 2, 1967, 54.

*futurum exactum*⁴ të disa gjuhëve të tjera si gjuhët neolatine perëndimore, gjermanishtja, anglishtja etj.; c) *do të kisha bërë / do kisha bërë*, me vlerën e së kryerës së kushtores, përkatësisht me vlerën e një *modus praesumptivus* për të shprehur veprime ose gjendje që mund të kenë ndodhur para një çasti të caktuar të së shkuarës.

Në të gjitha këto forma pjesëza «do», e cila për nga origjina s'është gjë tjetër veçse një formë e ngurosur e foljes «dua»⁵ në të tashmen e dëftores, është e desemantizuar. Si rrjedhim, e ardhmja e tipit *do të bëj*, e cila në filim ka qenë përdorur si një *futurum voluntatis*, sot përdoret si një e ardhme e mirëfilltë pa ndonjë nuancë volitive.

* * *

Mendimi i disa gjuhëtarëve në të kaluarën se tipi i së ardhmes me pjesëzën foljore «do» përdoret vetëm në toskërishte, e ka pasur burimin në njohjen e pamjaftueshme të materialit gjuhësor të shqipes së folur brenda dhe jashtë kufijvet politikë të shtetit shqiptar. Por materialet dialektologjike të mbledhura dhe të botuara sidomos gjatë këtyre 15-20 vjetëve të fundit, kryesisht nga dialektologë shqiptarë, kanë vërtetuar më së miri se këtë tip të së ardhmes e njohin, ndonëse në një masë më të kufizuar se në toskërishte, të gjitha të folmet gege, duke përfshirë këtu edhe ato të skajit më verior⁶. Madje, siç do të sqarojmë më tutje, gjurmë të kësaj të ardhmeje gjejmë që në veprën e Buzukut. Këtë tip të së ardhmes e kanë edhe të folmet e arbëreshëve të Greqisë, ku ai është i vetmi tip në përdorim, si edhe ato të arbëreshëve të Italisë, ku, siç dihet, përdoret më dendur e ardhmja e tipit *kam të bëj*. Gjurmë të së ardhmes me «do» hasen edhe në të folmet e disa kolonive shqiptare me origjinë gege si në të folmen e katundit Arbnesht afër

4) Shih për këtë K. Cipo, *Sintaksa*, 43; Sh. Demiraj, *dispensa e cituar*, 207; F. Agalliu, *art. cit.*, f. 133-4.

Të kihet parasysh se edhe në rumanishten e në greqishten e re e ardhmja e përparme (*futurum exactum*) përdoret më dendur për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës, d.m.th. me vlerë presumptive; shih për këtë *Gramatica limbii romine*, I (1963), f. 241; Maria Moser-Philtsov, *Lehrbuch der neugriechischen Sprache*, f. 97. Kjo e fundit shënon se në greqishten e re ky kuptim shprehet edhe me pjesëzën *ða* të ndjekur nga aoristi i dëftores.

5) Sipas mendimit më të përhapur, «do» për nga origjina është forma e vetës së tretë njëjës të së tashmes dëftore. E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* — dispensë — f. 81, shpreh supozimin se ajo «mund të jetë trajta e shkurtuar e *dua*, po mund të jetë edhe trajta e vetës së tretë të njëjësit». Ne nuk do të përjashtonim edhe një mundësi të tretë që «do» e së ardhmes ta ketë burimin edhe tek forma e vetës së dytë njëjës. Pa mundur të ndalemi më gjatë tash për tash në këtë çështje, këtu vetëm po shënojmë se fonetikiqist është më e mundshme që pjesëza «do» e së ardhmes ta ketë burimin tek forma e vetës së tretë ose të dytë njëjës. Megjithatë, do pasur parasysh se në veprën e Buzukut forma e vetës së tretë njëjës «do» ndiqet rregullisht nga paskajorja e tipit *me ba* dhe asnjëherë nga lidhorja. Kurse forma e vetës së parë njëjës «*duo*» ndiqet rregullisht nga e tashmja e lidhore. Edhe forma e vetës së dytë njëjës «do» në atë vepër ndiqet më fort nga e tashmja e lidhore, si p.sh.: *A do të banesh shëndosh?* (XLV/bis). Edhe në veprën Dotrina Christiana të Budit forma e vetës së parë njëjës «*duo*» ndiqet më fort nga e tashmja e lidhore, kurse format e vetavet të tjera ndiqen rregullisht nga paskajorja.

6) Përdorimin e së ardhmes me pjesëzën «do» edhe në gegërishte e kanë vënë në dukje, ndër të tjerë: N. Jokli, *Litteris* IV, nr. 3 (1927), f. 209; M. La Piana, *Studi linguistici albanesi* I, 151; M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, 69; W. Cimochowski, *Le Dialecte de Dushmani*, 113-4; I. Ajeti, *Istorijski razvitak ge-*

Zarës (shih I. Ajeti, Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, f. 102) dhe në të folmen e kolonisë shqiptare të Istriës (shih M. Bartoli, «Le reliquie del dialetto albanese dell' Istria», në «Studi albanesi» I, 1931, 7-9; I. Ajeti, Istarsko-arbanaski prevod priče o izgubljenom sinu, në «Godišnjak» I — Balkanološki Institut, Sarajevo 1957, f. 201).

* * *

Për sa i takon tipit të së ardhmes me ndihmësen «kam», përveç formave të tipit *kam me ba*, *kam për të bërë*, *kam të bëj*, përdoren edhe format e tipit *kisha me ba*, *kisha për të bërë*, *kisha të bëja*, me vlerën e së ardhmes në të shkuarën, përkatësisht me vlerën e kushtores (shih për këtë Demiraj, dispenca e cit. II, f. 195-6, 213).

Format më të zgjëruara të tipit *kam me pasë ba*, *kisha me pasë ba*, *kam për të pasë bërë*, *kisha për të pasë bërë*, që jep Kristoforidhi në gramatikën e tij, f. 102, 109, 113, 122, 125 etj., nuk ekzistojnë⁷.

E ardhmja e tipit *kam me ba*, siç dihet, përdoret vetëm në të folmet gege, sidomos në gegërishten veriore. Në të folmet toske ajo nuk përdoret e kjo lidhet drejtpërdrejt me mungesën e paskajores së tipit *me ba* në toskërishte⁸. Kurse formën e tipit *kam për të bërë* me vlerën e së ardhmes e njohin të dy kryedialektet e shqipes, megjithëse në gegërishten veriore ajo ka një përdorim më të kufizuar për shkak të gjallërisë relativisht të madhe të së ardhmes së tipit *kam me ba*. Ndërsa forma e tipit *kam me ba* e ka humbur nuancën e detyrimit, forma e tipit *kam për të bërë* e ruan në një farë mase këtë nuancë e kjo do lidhur me moshën relativisht të re të përdorimit të saj me vlerën e së ardhmes⁹.

Për sa i takon formës së tipit *kam të bëj*, që gjejmë kryesisht tek

gijskog govora Arbanasa kod Zadra, f. 102; I. Ajeti, Istarsko-arbanaski prevod priče o izgubljenom sinu, në «Godišnjak» I — Balkanološki Institut, Sarajevo 1957, f. 201; I. Ajeti, Nji shqyrtim i shkurtë mbi zhvillimin e futurit në shqipe, «Jeta e Re» 2, 1954, 122 v.; I. Ajeti, Historia e gjuhës shqipe, Prishtinë 1969, f. 97; I. Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës, Prishtinë 1960, f. 46; M. Begolli, Të folurit e Rugovës me disa veçori të veta, «Përparimi» 5, 1958, 317; L. Mulaku, Govor albanasa bajgorske Shalje, Prishtinë 1968, f. 215-216; E. Lafe, E folmja e Nikaj-Mërturit «St. fil.» 3, 1964, f. 128; Gj. Shkurtaç, E folmja e Kastratit, «St. fil.» 2, 1967, 54; Gj. Shkurtaç, Vëzhgime rreth të folmeve të malësorëve të Bregut të Matës, të ishullit të Lezhës e të ishullit të Shëngjinit, në «Lissus», Tiranë 1967, f. 167; Q. Haxhihasani, Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës, BUSHT, Seria Shk. shoq. 4, 1963, 131; B. Beci, Hulumtime gjuhësore në Mat, BUSHT, Seria Shk. shoq. 2, 1963, 224; B. Beci, E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës, «St. fil.» 4, 1964, 158; J. Gjinari, Vëzhgime mbi të folmen e Malësisë së Krutës, «St. fil.» 4, 1964, 122; J. Gjinari, Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, «St. fil.» 4, 1968, 134-5; M. Çeliku, Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit, «St. fil.» 4, 1965, 112; M. Çeliku, Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre, «St. fil.» 3, 1968, 130.

7) Edhe në Kartotekën e gramatikës pranë Institutit të historisë e të gjuhësisë nuk gjëndet asnjë gjurmë për këto forma.

8) Për përdorimin e këtij tipi të së ardhmes nga N. Filja, shih vepërzën «I krështeu i arbresh» të botuar nga M. Markiano në Romë më 1911, f. 18, 19. Shih edhe vërejtjet tona në «St. fil.» 1, 1969, 94.

9) Siç e kemi vënë në dukje edhe më parë (shih «St. fil.», 2, 1969, 57, shën. 175), forma e së ardhmes e tipit *kam për të bërë* si dhe ajo e tipit *kam me ba* janë përfutuar nga gramatikalizimi i togfjalëshave të kallëzuesorë korespondues me nuancë detyrimi.

arbëreshët e Italisë¹⁰, ajo duhet të jetë relativisht e vjetër. Për këtë dëshmon jo vetëm përdorimi i saj relativisht i dendur tek Matrënga dhe tek autorë të tjerë arbëreshë, por edhe ngurtësimi i ndihmëses *kam* në formën e vetës së tretë njëjës (*ka*) për të gjitha vetat (shih D. Camarda, Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese, 266, ku *ka* të shpjegohet, sipas nesh jo saktë, nga *kam të*). Por me gjithë vjetërsinë e saj relative, kjo formë në disa raste e ka ruajtur në një farë mase nuancën e detyrimit¹¹.

* * *

Pra, siç shihet, si tipi i së ardhmes me pjesëzën «do» ashtu edhe ai i së ardhmes me ndihmësen «kam» janë në përdorim në të dy kryedialektet e shqipes, por me një mbizotërim të tipit të parë në toskërishte dhe të tipit të dytë në gegërishte si edhe tek arbëreshët e Italisë.

* * *

Por në shqipen e sotme me kuptimin e së ardhmes mund të përdoret edhe e tashmja e dëftores (shih për këtë Cipo, Gramatika shqipe, 112; Demiraj, dispensa cit., 198) si edhe e tashmja e lidhore (shih Cipo, vep. cit., 116; Demiraj, dispensa cit. 210).

Përdorimi i së tashmes së lidhore me vlerën e së ardhmes në shqipen e sotme ndodh vetëm në këto rrethana:

I. Kur ajo përdoret në fjali të varura, në rast se kallëzuesi i fjalisë drejtuese është një folje në kohën e tashme ose në të ardhmen e dëftores, ose në të kryerën e thjeshtë të prirë nga lidhëza nënrenditëse kushtore *po* (shih për këtë Demiraj, dispensa cit., 203). Në këtë rast e tashmja e lidhore është sinonime me paskajoren.

II. Kur përdoret në fjali të pavarura:

1) Me vlerën e mënyrës urdhërore.

2) Me vlerën e mënyrës dëshirore.

3) Në fjali pyetëse të drejta, që nisin me një përemër pyetës me një ndajfolje pyetëse, më pjesëzën pyetëse *a*, ose pa ndonjë fjalëz pyetëse. Në këtë rast lidhëza për nga kuptimi është e barazvlershme me paskajoren të prirë nga një folje modale. Të krahasohen p.sh. shqip *Ç'të bëj?*; gjermanisht *Was soll (durf) ich tun?*; anglisht *What shall (can) I do?*; frëngjisht *Que dois-je (puis-je) faire?* Gjithashtu të krahasohen shqip *Të shkoj atje?*; gjermanisht *Soll ich dort gehen?*; anglisht *should (may) I go there?*; frëngjisht *Dois-je (puis-je) y aller?*

Në fjali të tilla mund të përdoren edhe e pakryera e më rrallë edhe e kryera dhe më se e kryera e lidhore.

4) Në fjali pyetëse-thirrëse, me anë të të cilavet folësi shpreh një

10) Ndonjë gjurmë e këtij tipi haset edhe në të folmet jugore të Shqipërisë. Ndonjë gjurmë haset edhe në dorëshkrimet e të ashtuquajturit Anonimi i Elbasanit si edhe tek proverbat e botuara nga S. Kolea.

11) Sipas M. Lambertz-it, KZ, 52. Band (1923) 1/2. (Doppel-Heft) f. 54, në të folmet arbëreshe të Molises ky tip i së ardhmes e ka ruajtur «kuptimin e domosdosë», kurse ai me «do» ka ruajtur «kuptimin e dëshirës».

Por tek N. Filia, vep. cit., f. 24, gjejmë të përdorur me nuancën e detyrimit edhe të ardhmen e përparme me pjesëzën «do». Ja si shkruan ai:

M. — Kūr kā të zerë fll t'agrōnjë?

D. — Do ket bërë një zet viet.

ndjenjë zemërimi, proteste etj., si p.sh. *Unë të vete atje?* (shih Demiraj, dispenca cit. 211). Edhe në këtë rast lidhorja është e barazvlershme me paskajoren të prirë nga folja modale *duhet*, si p.sh. gjermanisht [Was?!] *Ich soll (muss) dort gehen?!*; anglisht [What?!] *I [should go there]?!*; frëngjisht [Quoi?!] *moi [je dois] y aller?!*

Në fjali të tilla mund të përdoren edhe e pakryera dhe e kryera e lidhore, e më rrallë edhe më se e kryera e lidhore.

* * *

Por, siç u vu në dukje edhe më sipër, e tashmja e lidhore tek Buzuku përdoret edhe në fjali të pavarura dëftore me vlerën e së ardhmes si sinonime me formën analitike të tipit *kam me bā (m)*. Në të njëjtin tip fjalish Buzuku përdor edhe të pakryerën e lidhore, ose të lidhore-habitores¹², me vlerën e së ardhmes në të shkuarën, përkatësisht me vlerën e kushtores. P.sh.¹³

Për të vërtetë, për të vërtetë u juve thom se ju të klani e të anë-koni, e shekulli të gëzonetë. E ju të zemërkeqī, e të zitë kā me u kthym nder gazëmend. («Meshari», LXVII/bis) «Amen, amen dico vobis: quia plorabitis, et flebitis vos, mundus autem gaudebit; vos autem contrastabimini, sed tristitia vestra vertetur in gaudium» (Gjoni 16/20).

Ma mjerë aj nieri qi ʔ si i Biri nierit vjen tradhëtuom; ma mirë të klenëk për të të mos klenëk lenë (LXIV). «Vae autem homini illi, per quem Filius hominis tradetur, bonum erat ei, si natus non fuisset homo ille».

... e ju në njihnitë muo, e atënë tem të njohkishtë. (LIX) «... si me sciretis, forsitan et Patrem meum sciretis» (Gjoni 8/19).

Format e lidhore, përkatësisht lidhore-habitores, të përdorura me vlerën e së ardhmes, përkatësisht me vlerën e mënyrës kushtore, në fjali të aspektit mohor Buzuku i shoqëron herë me pjesëzën *mos*, herë me pjesëzën *nuk* (1 herë edhe me pjesëzën *s'*). P.sh.

Për pak mot ju të mos më shihni, e përhap për pak mot ju të më shihni ... (LXVII/bis) «Modicum, et jam non videbitis me: et iterum modicum, et videbitis me ...» (Gjoni 16/16).

... e aj qi të vinjë tek u, u nukë ta qes jashtë. (LXXXIX) «... et eum, qui venit ad me, non eiciam foras.» (Gjoni 6/37).

E kish pasunë fjalë ʔ Shpirtit shenj, aj të mos bdis parë se të mos shih ... (LXXXIV/bis) (Et responsum acceperat a Spiritu Sancto, non visurum se mortem, nisi prius videret ...) (Luka 2/26).

E në mos shkurtonishnë ato dit, nukë të shëlbone gjithë mish, por për të zgjedhunitë të shkurtonenë ato dit. (LXXXII/bis) «Et nisi breviati fuissent dies illi, non fieret salva omnis caro: sed propter electos breviabuntur dies illi.» (Mateu 24/22).

A s të mujtëke kŷ, qi sytë e d verbënit lenë ʔçilën, me bām ky qi mos vdis? (XL) «Quidam autem ex ipsis dixerunt: Non poterat hic, qui aperuit oculos caeci nati, facere ut hic non moreretur?» (Gjoni 11/37).

12) Është fjala për format e tipit të *qenkësha*, që kanë vecoritë formale të lidhore dhe të habitores, por që për nga modaliteti dhe funksionet anojnë nga lidhorja; për këtë shih vërejtjet tona në BUSHT. Seria Shk. shoq. 1, 1959, 59-60.

13) Shembujt ilustrues prej Buzukut janë nxjerrë nga «Meshari» i Gjon Buzukut, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e dytë, Tiranë 1968.

Përdorimi i lidhore tek Buzuku, krahas formës analitike të tipit *kam me bā (m)*, nuk mund të jetë një «shfaqje «krijimtarie gjuhësore strukturore» të vetëdijëshme» nga ana e tij, siç përpiqet ta argumentojë S. Riza, Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe (dispensë, Tiranë 1961) f. XXIX-XXX. Shkrimtarët, duke përfshirë edhe ata që njihen për pregatitjen e tyre të shquar gjuhësore, nuk kanë si të krijojnë forma të reja gramatikore, që do ta vështirësonin së tepërmi kuptimin e shkrimevet të tyre. Shumë-shumë një shkrimtar mund të gjallërojë ndonjë formë gramatikore, që ka nisur të bëhet arkaike. I tillë, mendoj, mund të jetë edhe rasti i përdorimit të lidhore me vlerën e së ardhmes tek Buzuku. i cili këtë përdorim ndofta e ka gjallëruar më shumë nga sa ishte i rëndomtë në kohën e tij. Me karakterin arkaik të një përdorimi të tillë të lidhore duhet shpjeguar ndofta edhe lëkundja e Buzukut në përdorimin herë të pjesëzës *nuk (a s')* e herë të pjesëzës *mos* (që ai e përdor relativisht më dendur) para formavet të së tashmes e të së pakryerës lidhore, kur këto kanë vlerën e së ardhmes, përkatësisht të së ardhmes në të shkuarën apo të kushtores. Një lëkundje e tillë në përdorimin e pjesëzavet të mohimit tek Buzuku vihet re edhe në raste të tjera. Në përgjithësi ai pjesëzën *mos* e përdor relativisht më dendur se në shqipen e sotme dhe e vendos atë ndonjëherë edhe para kohës së tashme të mënyrës dëftore, në vend të pjesëzës *nuk*, si edhe në vend të lidhëzës *as*, si p.sh.:

Do me thashunë se qish *mos do* të të jetë *bām tÿ*, ti *mos* e bajnsh kujnaj. Ti *mos* dëshërojsh gruonë e shoqit, *mos* motërë, *mos* bijënë për dhunë (XXI/bis).

Lidhur me përdorimin e lidhore me vlerën e së ardhmes tek Buzuku sot për sot është vështirë të jepet një mendim i prerë nëse kemi të bëjmë me një inovacion të dialektit të Buzukut apo me një dukuri të trashëguar nga një fazë më e lashtë e zhvillimit të shqipes. Po të vëretohej hipoteza e dytë, atëherë edhe gjuha shqipe me monumentin e saj më të vjetër do të jepte një dëshmi të mëtejshme në të mirë të tezës së njohur, sipas të cilës gjuhët indoevropiane në një fazë më të lashtë nuk kanë pasur forma foljore të posaçme për të shprehur kuptimin e kohës së ardhme, të cilën e jepnin me anë të «së tashmes» së mënyrës dëftore ose të lidhore (shih për këtë Brugmann, Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen. II. Band, III Teil, I Lieferung (1913), f. 49).

Sidoqoftë, ne mendojmë se përdorimi i lidhore në të dy kryedialektet e shqipes si në fjali të pavarura ashtu edhe në fjali të varura, sidomos pas foljes *dua* dhe pas foljes modale *mund* (për këto shih edhe vërejtjet tona këtu më poshtë), meriton një studim të veçantë, sidomos në planin diakronik.

II

Tipi i së ardhmes i formuar me anë të foljes «*dua*» është i përhapur edhe në gjuhë të tjera ballkanike si greqishtja, bullgarishtja, rumanishtja, maqedonishtja dhe serbokroatishtja (shih Sandfeld, Linguistique balkanique, 182 v., Weigand, Bulgarische Grammatik, 139; H. G. Lunt, Grammar of the Macedonian literary language, 82; M. Stevanović, Savremeni srpskohrvatski jazik, 362; Gramatica limbii române I (bot. II-1963), 269 v.

Edhe tipi i së ardhmes me ndihmësen «*kam*» ka një përhapje re-

lativisht të gjerë në gjuhët e Ballkanit (shih Sandfeld, vep. cit., 184). Përveç shqipes atë e gjejmë edhe në gjuhët sllave të Ballkanit si bullgarishtja (shih Stefan Mladenov, Geschichte der bulgarischen Sprache, 260; shih edhe Weigand, vep. cit. 139); maqedonishtja (shih H. G. Lunt, vep. cit., 82-3), rumanishtja (am sã scriu - shih Al. Roset ti, Istoria limbii române IV. V. VI. - 1966 - f. 292, shih edhe Gramatica limbii române I, 270). Ky tip nuk është i panjohur edhe në serbokroatishte e në slovenishte (shih Vondrak, Vergleichende slavische Grammatik, II, 151-2). Ky tip i së ardhmes nuk ka qenë i panjohur edhe në greqishten bizantine (shih Dieterich, Untersuchungen, 246, cituar sipas Sandfeldit, vep. cit., 184).

Për sa i takon burimit të së ardhmes së formuar me anë të foljes «*dua*» në gjuhët e Ballkanit, siç dihet, janë dhënë shpjegime të ndryshme. Pikënisjen e kësaj dukurie si edhe të disa dukurive të tjera ballkanike, si p.sh. humbja e paskajores¹⁴, disa dijetarë e kanë kërkuar në gjuhën greke dhe disa të tjerë në «trako-shqipen». Por ka edhe gjuhëtarë, që nuk kanë miratuar asnjërën nga këto dy teza, duke e konsideruar formimin e së ardhmes me «*dua*» në gjuhët e Ballkanit si një zhvillim paralel.

Përfaqësuesi më i njohur i tezës së parë, siç dihet, është Kr. Sandfeldi. Ky dijetar (Ling. balk. 181 v.), duke cituar Dieterich-un, Untersuchungen, 245, thotë se që nga shekujt e parë të erës sonë në gjuhën greke togfjalëshi $\delta\epsilon\lambda\omega$ + paskajore përdoret për të shënjuar të ardhmen, dhe, duke u mbështetur tek Thumb-i, Handbuch der neugriechischen Sprache, § 226, shton se «ky formim është ruajtur në dialekte të ndryshme gjer në ditët tona». Sipas Sandfeldit, e ardhmja e tipit $\delta\epsilon$ vã γράφω, që më vonë u reduktua në $\delta\acute{\alpha}$ γράφω, ka lindur që në greqishten e mesme.

Kurse përfaqësuesi më i njohur i tezës së dytë, siç dihet, është G. Weigand-i. Ky dijetar në BA I, f. X ka shprehur mendimin se ky tip i së ardhmes duhet të jetë shumë i vjetër dhe duhet ta ketë burimin tek «trako-shqipja» e që këtej ka kaluar qysh në kohë të vjetra në greqishte e gradualisht është përhapur edhe më tej.

Edhe përsa i takon burimit të së ardhmes me ndihmësen «*kam*» këta dy dijetarë kanë dhënë shpjegime të ndryshme. Sandfeldi, vep. cit., 185, thotë se «përdorimi i «*kam*» për të shënjuar të ardhmen është një fakt roman që bie shumë në sy»; dhe që këtej nxjerr përfundimin se «nuk ka asgjë të jashtëzakonshme që ky [tip i së ardhmes - Sh. D.] të shfaqet gjithashtu edhe në Ballkanet, ku latinishtja ka luajtur një rol aq të madh. Vetëm mbizotërimi i kësaj të ardhmeje në shqipen veriore dhe prania e saj në rumanishte duket të tregojnë se e ardhmja e formuar me ndihmën e foljes «*dua*» ka ardhur nga jugu».

Duke miratuar mendimin e Joklit («Litteris» IV, nr. 3, 207-8), sipas të cilit habitörja e shqipes në zanafillë ka qenë një e ardhme e përbërë nga paskajorja pa pjesëzën *me* dhe nga ndihmësja «*kam*» e pasve-ndosur¹⁵, Sandfeldi (vep. cit. 185) nxjerr përfundimin se tipin e së

14) Shih për këtë artikullin tonë Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, «St. fil». 1. 1969, 82 v.

15) Ne nuk pajtohemi me këtë shpjegim të Joklit dhe shpresojmë të merremi më gjatë me këtë çështje në një rast tjetër.

ardhmes me «kam» dikur e ka pasur edhe toskërishtja dhe, si rrjedhim, ky tip është i vjetër në gjuhën shqipe; lidhur me këtë ai shton: «... dhe kështu provohet se tipi «dua» + lidhore është një inovacion në atë gjuhë».

Sipas Sandfeldit, vep. cit. 184, Weigand-i edhe për të ardhmen e tipit *kam me shkruem* të shqipes veriore ka shprehur mendimin se është trashëguar nga trakishtja.

Mendimin e Sandfeldit mbi ndikimin grek në përhapjen e së ardhmes me pjesëzën «do» në shqipen jugore dhe mbi ndikimin roman për të ardhmen me ndihmësen «kam» në shqipen veriore e ka miratuar edhe Jokli («Litteris» IV, nr. 3, 209).

Këto mendime të Sandfeldit i citon edhe E. Hamp-i në kumtesën e tij «La langue albanaise et ses voisines» (Actes du premier congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Sofia 1968, f. 668). Por ai, duke u mbështetur në të dhënat e I. Ajetit (Istorijski razvitak gegiskog govora Arbanasa kod Zadra, Sarajevo, 1961, f. 102) dhe të W. Cimočovsk-it (Le Dialecte de Dushmani, Poznan 1951, f. 113-4) e pranon përdorimin e së ardhmes me foljen «dua» edhe në gegërishten e «veriu-ekstrem», ku, sipas tij, ky tip duhet konsideruar si një depërtim nga të folmet sllave rreth e rrotull (kumtesa cit. f. 668).

Mendimin që tipi i së ardhmes me pjesëzën «do» në gjuhën shqipe është formuar nën ndikimin e greqishtes e kanë kundërshtuar M. La Piana, I. Ajeti, M. Domi dhe J. Gjinari.

M. La Piana, Studi linguistici albanesi I, 151, jo vetëm që e kundërshton tezën e Sandfeldit që e ardhmja me pjesëzën «do» është formuar nën ndikimin e greqishtes, por nuk pranon as mendimin tjetër të Sandfeldit, i cili, duke u mbështetur në interpretimin e Joklit mbi habitoren, pohoi se dikur edhe në toskërishte ka ekzistuar vetëm tipi i së ardhmes me ndihmësen «kam». La Piana ishte i mendimit se si e ardhmja me ndihmësen «kam», si një e ardhme e domosdosë, ashtu edhe ajo me foljen «dua», si një e ardhme volitive, janë të vjetra në gjuhën shqipe (shih vep. cit. f. 149-151).

Edhe I. Ajeti në artikullin «Nji shqyrtim i shkurtë mbi zhvillimin e futurit në shqipe» («Jeta e Re» 2, 1954, 122), megjithëse pranon që e ardhmja e tipit *kam* + paskajore është shumë më e vjetër se format e tjera të së ardhmes në gjuhën shqipe, e kundërshton mendimin e Sandfeldit mbi ndikimin e greqishtes në fushën e gramatikës.

M. Domi në Morfologjia historike e shqipes, f. 70, si përmend mendimin e Weigand-it dhe atë të Sandfeldit mbi gjenezën e së ardhmes me «do» në gjuhët e Ballkanit, shton: «Po s'përrjashtohet edhe poligjeneza; ky tip futuri mund të jetë krijuar në këto gjuhë në mënyrë të pavarur, se edhe në gjuhë të tjera togjet foljore: e tanishme e foljes *dua* me paskajoren e një foljeje tjetër janë në rrugën e marrjes së kuptimit të futurit (p.sh. *frangjisht je veux faire*)».

Mendimin e fundit ai e rritheksion edhe më vonë (shih Actes du premier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes, VI, Sofia 1968, f. 672), ku, pasi vë në dukje se ka më shumë të ngjarë që e ardhmja me foljen «dua» të jetë krijuar «në mënyrë të pavarur, të paktën përsa i takon shqipes», shton: «Ndikimi i greqishtes mbi shqipen do të jetë ndjerë jo në formimin e kësaj të ardhmeje, në origjinë, por më vonë mbi dialektin jugor në zgjedhjen midis formave ekzistuese, duke shkaktuar mbizotërimin absolut të formës me ndih-

mësen «dua», pastaj mënjanimin e formës tjetër me ndihmësen «kam» në atë dialekt».

M. Domi (dispensa cit., 69-70) është i mendimit se «shqipja e për-bashkët e lashtë» i ka pasur si tipin e së ardhmes me «kam» (si një *futurum necessitatis*) ashtu edhe të ardhmen me «do» (si një *futurum voluntatis*).

Edhe J. Gjinari në artikullin «Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe», «St. fil.» 4, 1968, 134 v. e vë në dukje faktin se si tipi i së ardhmes me «do» ashtu edhe ai i së ardhmes me «kam» përdoren në të dy kryedialektet e shqipes dhe që këtej nxjerr përfundimin: «Në qoftë se mendimi mbi ndikimin e greqishtes në formimin e futurit *do* + lidhore bazohet në bindjen se ky tip është vetëm i toskërishtes, atëhere fakti që ai ekziston në të gjithë shqipen besoj se ja heq bazën mbështetëse këtij mendimi».

J. Gjinari (art. cit., f. 135) pranon si më të vjetra format e tipit *kam* + lidhore dhe *kam* + paskajore «për shkak të formës më të ngulitur, deridiku edhe të funksionit».

* * *

Unë mendoj se problemi i formavet të kohës së ardhme në gjuhët ballkanike në përgjithësi dhe në gjuhën shqipe në veçanti duhet parë në një kuadër më të gjërë. Për një zgjidhje sa më bindëse të këtij problemi duhen pasur parasysh edhe këto fakte gjuhësore:

1) Në përgjithësi në gjuhët indoevropiane vihet re një prirje relativisht e hershme për të krijuar forma analitike¹⁶ për shenjimin e kuptimit të kohës së ardhme. Këto forma analitike janë ndërtuar me anë të një foljeje ndihmëse dhe paskajores, përkatësisht lidhore, së foljes themelore. Si folje ndihmëse për formimin e së ardhmes kanë shërbyer sidomos ato folje, të cilat në kohën e tashme, të ndjekura nga një folje tjetër, shprehin kuptimin modal të dëshirës ose të detyrimit lidhur me një veprim ose gjendje, që folësi kërkon të vërtetohet në të ardhmen. Të tilla janë foljet «dua», «kam», «jam» etj. (shih për këtë: O. Jespersen, *The Philosophy of Grammar*, 8th edition, London 1958, f. 260-262; A. Meillet, *Linguistique historique et linguistique générale*, 2^e édition, Paris 1926, f. 144-146).

2) Ndërtimi i së ardhmes me anë të foljes «dua» nuk është një dukuri thjesht ballkanike e këtë e pranon edhe Sandfeldi (vep. cit. 181), i cili përmend me këtë rast gjuhët skandinave dhe disa dialekte franceze. Ky tip ndërtimi është i njohur edhe në disa gjuhë të tjera gjermanike. P.Sh. në gjermanishte, sidomos në gjermanishten e lartë të vjetër dhe të mesme, me vlerën e kohës së ardhme përdorej folja modale «*wollen*» e ndjekur nga paskajorja e foljes themelore (shih H. Paul, *Deutsche Grammatik*, IV, 147 v.; E. A. Krasheninnikova, *Modalbnye glagoly i çastici v nemeckom jazyke*, Moskva 1958, f. 64). Ky tip ndërtimi me vlerën e kohës së ardhme ka pasur dhe ka ardhur duke marrë një përdorim më të gjërë në gjuhën angleze (shih O. Jespersen, *A. Modern English Grammar*, Part IV, 3rd volume, ribotimi i v. 1965, London, f. 244-253;

16) Siç dihet, në disa gjuhë neolatine ndërtimi analitik i tipit *scribere-habeo* ka përfunduar në një fjalë të përngjitur, krahaso p.sh. italishten *scrivere* dhe frëngjishten *écrire* etj.

A. Mielllet, vep. cit., 145; B. A. Пыш, Историја англиског јазыка, Москва 1958, f. 113 v., 223 v., 334).

Edhe në latinishte, sidomos në latinishten e krahinavet danubiane, folja «*dua*» e ndjekur nga paskajorja është përdorur për të shprehur kuptimin e së ardhmes (shih për këtë H. Mihăescu, Limba latină în provinciile dunărene ale imperiului roman, București 1960, f. 142-3; Istoria limbii române, II - Editura Ac. Rep. Soc. România, 1969, f. 87)¹⁷.

Tipi i së ardhmes me «*dua*» nuk ka qenë i panjohur edhe në sllavishten e vjetër kishëtare (shih Vondrak, Vergleichende slavische Grammatik, II, 150).

Ky tip ndërtimi nuk është i panjohur edhe në gjuhë të tjera jo-balkanike si frengjishtja, ku togfjalëshi i tipit *je veux faire* ka marrë kuptimin e së ardhmes (shih A. Meillet, vep. cit. 146; J. Vendryes, Le langage, Paris, bot. i vitit 1950, f. 179-180; M. Domi, dispensa cit., 70. Shih edhe Barić, Balkanologische Sprachstudien¹⁸, në «Godišnjak» II-1961 - f. 60, ku vihet në dukje se këtë tip futuri e njohin disa dialekte të frengjishtes lindore si edhe valdishtja e sipërme e vjetër. Duke u mbështetur tek Leo Spitzer-i, Italienische Umgangssprache, f. 89, 1, Barići shton se ky tip futuri nuk është krejt i panjohur edhe në italishtë¹⁹.

3) Kohën e ardhme me foljen «*dua*» nuk e ka vetëm toskërishtja, siç është pandehur nga disa gjuhëtarë në të kaluarën, por edhe gegërishtja (shih shën. 6), veçse në gegërishten veriore ky tip ndërtimi ka një përdorim më të kufizuar për shkak të përdorimit më të dëndur të së ardhmes së formuar me anë të foljes «*kam*». Madje, edhe përdorimi i formës së tipit *do të kem baj do të kem bërë* me vlerë prezumtive nuk është i panjohur edhe në të folmet e gegërishtes veriore (shih shën. 3). Për më tepër, siç u vu në dukje edhe më sipër, gjurmë të së ardhmes me «*do*» gjejmë që në veprën e Buzukut (f. LVIII = 68).

A nukë *do të pī* kelqinë qi më ordhënoi Ati? «Calicem, quem dedit mihi Pater, non *bibam*?» (Gjoni 18/11).

Ky është i vetmi rast²⁰ që Buzuku ka përdorur të ardhmen e tipit *do të pī*. Por edhe ky rast i vetëm dëshmon qartë, sipas nesh, se ky tip futuri nuk ka qenë i panjohur në gegërishten e kohës së Buzukut.

Veç kësaj, në veprën e Buzukut gjejmë të përdorur me vlerën e një futuri volitiv edhe togfjalëshin e tipit *duo* + e tashmja e lidhore, gjë që e vuri re së pari La Piana (Stud ling. alb. I, 150), i cili shënjon këtë rast: ... e hinje se u *duo të përfaronj* ata ɳ dheut (LX) «... et ego *disperdam* eos cum terra». M. Domi (dispensa cit., 69) përveç këtij rasti shënjon edhe: Përse u *duo të siell* ditënë e gjyqit përmbi dhët me ujëna... (LX) «Ecce ego *adducam* aquas diluvii super terram, ut inter-

17) Sipas H. Mihăescu-t, vep. cit. 142, «*Shprehja volo cantare* është ruajtur në *voi cînta*» të rumanishtes. Një mendim i ngjashëm është shprehur edhe në Istoria limbii române, II, f. 89, ku nuk përjashtohet mundësia që në ruajtjen e këtij tipi të së ardhmes në rumanishte të ketë pasur një farë ndikimi edhe «lidhja e veçantë e latinishtes danubiane me greqishten e mesme, ku e ardhmja formohet me ndihmësen *δελω* «*dua*».

18) Në pjesën III të këtij artikulli, f. 60 v., ku bën fjalë për të ardhmen në rumanishte dhe veliotishte, Barići e vë në dyshim ndikimin grek në formimin e së ardhmes me «*dua*» në ato dy gjuhë; ai nuk pranon në këtë rast as ndikimin e shqipes.

19) Siç na dëshmon J. Vendryes-i, vep. cit., 179, edhe në një gjuhë jo-indo-evropiane, siç është gjuha kineze, e ardhmja ndërtohet me ndihmën e foljes «*dua*».

20) Me sa duket, këtë rast ka pasur parasysh J. Gjinari në «St. fil.» 4, 1968, 134, ku, duke u mbështetur në një kumtim të E. Lafes, pohon: «Tek Buzuku futuri *do* + lidhore del vetëm një herë».

ficiam omnem carnem...» (Gjeneza 6/17). Përveç këtyre dy rasteve ne kemi vënë re se Buzuku e ka përdorur këtë tip togfjalëshi për të shprehur veprime të së ardhmes edhe në disa raste të tjera, ku këtij togfjalëshi në tekstin latin i përgjigjet ose e ardhmja ose e tashmja me vlerën e së ardhmes:

Hinje se u *duo* t u *banj* t u bjerë buka n qiellat... (LXIII - LXIII/bis) «Ecce ego *pluam* vobis panes de caelo...» (Eksodi 16/4). ... e mbas këso fjalësh tha atyne: Laxëri miku ynë po rfle; ma u *duo* të *vete* përse ata nqonj n gjumit. (LVIII/bis) «... et post haec dixit eis: Lazarus amicus noster dormit: sed *vado* ut a sonno excitem eum». (Gjoni 11/11).

E tha Izaku Jakobit: Pa m u afëro, se *duo* të të *përkas*; o biri em... (XLIX/bis). »Dixitque Isaac: Accede huc, ut *tangam* te, filii mi...» (Gjeneza 27/21).

Por me sa parashtruam këtu më sipër, ne nuk duam të themi se togfjalëshi i tipit *duo* + e tashmja e lidhore tek Buzuku paraqitet i grammatikalizuar si një futur volitiv. Qëllimi ynë është të vemë në dukje se edhe në gegërishte, siç na dëshmon monumenti i saj më i vjetër i njohur gjer më sot, ka ekzistuar premisa për formimin e këtij tipi të së ardhmes. Këtë premisë ne e shohim sidomos në faktin që tek Buzuku, i cili e përdor dëndur paskajoren e tipit *me ba*, folja *dua* (në vetën e parë dhe pjesërisht edhe në vetën e dytë njëjës të së tashmes dëftore - shih shën. 5) përdoret fare natyrshëm e ndjekur nga një folje tjetër në të tashmen e lidhore, edhe kur të dyja këto folje kanë të njëjtën kryefjalë. Një ndërtim i tillë është i pamundur në ato gjuhë, ku paskajorja ka gjithashtu një përdorim të dëndur, si p.sh. në gjuhët neolatine të perëndimit, në gjuhët gjermanike, në gjuhët sllave etj. ku folja «*dua*» ndiqet detyrimisht nga paskajorja, në rast se i gjithë togfjalëshi ka një kryefjalë të përbashkët²¹.

E ardhmja e tipit *do të bëj* në gjuhën shqipe duhet të jetë relativisht mjaft e vjetër. Për këtë dëshmon jo vetëm ngurosja e modales *do* dhe humbja e plotë e nuancës volitive tek ky tip i së ardhmes, por edhe përhapja e saj nëpër dialektet e shqipes, duke përfshirë këtu edhe ato të arbëreshëve të Italisë e të Greqisë.

4) Tipi i së ardhmes me foljen ndihmëse «*kam*» nuk del vetëm në gjuhët romane e ballkanike, por edhe në gjuhë të tjera si sllavishtja e vjetër (shih F. Bopp, Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen, f. 477; Vondrak, Vergleichende slavische Grammatik, II. 150; Rajko Nahtigal; Die Slavischen Sprachen, Abriss der vergleichenden Grammatik, Wiesbaden, 1961, f. 61, 239), bullgarishtja, (shih Weigand, Bulgarische Grammatik, 140), serbo-kroatishtja (shih Vondrak, vep. cit., 151), si edhe në disa gjuhë të tjera sllave (shih Vondrak, vep. cit. 152-153). Tipi i së ardhmes me *kam* ka qenë përdorur edhe në rusishten e vjetër (shih Vondrak, vep. cit., 152; shih edhe V. I. Borkovskij — P. S. Kuznecov, Istoriceskaja grammatika russkogo jazyka, Moskva 1965, f. 301).

5) Tipin e së ardhmes me «*kam*» nuk e ka vetëm shqipja veriore, ku duhet të jetë relativisht mjaft e vjetër; (të kihet parasysh se në veprat

21) Në veprën e Buzukut (e aq më shumë tek Budi) edhe folja me vlerë modale *mund* ndiqet zakonisht nga lidhorea dhe më rrallë nga paskajorja e tipit *me ba*, kurse në gjuhë të tilla si gjuhët neolatine të perëndimit, gjuhët gjermanike etj. ajo ndiqet vetëm nga paskajorja.

e autorëve të vjetër veriorë e ardhmja e tipit *kam me ba(m)*, përdoret shpesh pa nuancën e detyrimit). Edhe në shqipen jugore gjatë këtyre shekujve të fundit ka ardhur duke u përdorur relativisht gjithnjë e më dendur me vlerën e së ardhmes forma e tipit *kam për të bërë*, që ruan në një farë mase edhe nuancën e detyrimit të togfjalëshit të tipit *kam + për të bërë* (shih për këtë Demiraj, Emrat prejfoljorë asnjans dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre, në «St. fil». 2, 1969, 54, 57; Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, — dispensë — II, f. 207).

Për më tepër, do pasur parasysh se në të folmet e arbëreshëve të Italisë, që për nga veçoritë fonetike e gramatikore janë shumë afër të folmeve të Shqipërisë Jugore, dokumentohet që heret përdorimi i së ardhmes së tipit *kam të bëj*. Ky tip ndërtimi, që dëshmohet qysh në veprën e Matrëngës (1592), nuk është i panjohur edhe në ndonjë të folme të Shqipërisë Jugore e ndonjë gjurmë e tij haset më ndonjë rast edhe tek arbëreshët e Greqisë (shih p.sh. Reinhold, Noctes Pelasgicae, Anthologia, f. 9).

6) Përsa i takon pyetjes se cili tip është më i vjetër në gjuhën shqipe, tipi i së ardhmes me ndihmësen «*kam*» apo ai me pjesëzën foljore «*do*», është vështirë të jepet sot për sot një përgjigje e prerë. Siç u vu në dukje edhe më sipër, Sandfeldi (Ling. balkanique, 185), I. Ajeti («Jeta e Re», 2, 1954, 122) dhe J. Gjinari («St. fil.» 4, 1968, 135), mbajnë më të vjetër tipin e së ardhmes me ndihmësen «*kam*». Kurse La Piana (Studi linguistici albanesi I, 151) të dy tipat i mban për të vjetër (që përpara Buzukut).

Po të nisemi nga dokumentimi më i hershëm, atëhere tipi i së ardhmes me ndihmësen «*kam*» del më i vjetër. Por ky argument nuk është i mjaftueshëm, sepse, siç dihet toskërishtja (duke përjashtuar të folmet e arbëreshëve të Italisë) dokumentohet me shkrim mjaft vonë (shek. XVIII). Nga ana tjetër, edhe mospërdorimi i tipit të së ardhmes me «*do*» në veprën e Matrëngës nuk do të thotë se në të folmet arbëreshe të kohës së tij (shek. XVI) nuk ekzistonte ky tip i së ardhmes. Dihet se në ato të folme, siç u vu në dukje edhe më sipër, krahas tipit *kam të bënj* përdoret edhe tipi *do të bënj*, të cilin arbëreshët e Italisë, sipas mendimit tonë, e kanë të trashëguar nga të folmet e visevet, prej nga u shpërngulën stërgjyshërit e tyre.

Sidoqoftë, çështja e vjetërsisë së këtyre dy tipave të së ardhmes së shqipes mbetet e hapur.

* * *

Po të mbahen parasysh faktet gjuhësore, që u përmendën këtu më sipër, atëhere teza e Sandfeldit që tipi i së ardhmes me foljen «*dua*» në gjuhët e Ballkanit është përhapur nën ndikimin e greqishtes, kurse tipi tjetër me folje «*kam*» është përhapur nën ndikimin e latinishtes, mbetet një hipotezë e paargumentuar. Mundësia e një zhvillimi paralel, sidomos për shqipen, nuk mund të përjashtohet a priori vetëm duke invokuar «superioritetin kultural» të greqishtes apo të latinishtes, aq më tepër kur formime të këtij lloji janë përfutur edhe në shumë gjuhë të tjera jashtë Ballkanit.

Përsa i takon gjuhës shqipe, është shumë kuptimplot fakti që pothuaj në të gjitha të folmet e saj, duke përfshirë edhe ato të arbëreshë-

vet të Italisë, janë në përdorim si tipi i së ardhmes me foljen «dua» ashtu edhe ai me foljen «kam». Është e vërtetë se në Shqipërinë Jugore dhe të Mesme²² mbizotëron tipi i parë, kurse në Shqipërinë Veriore mbizotëron i dyti. Por ky ndryshim dialektor nuk është e domosdoshme të shpjegohet vetëm me tezën e porsashqyrtuar të Sandfeldit, qoftë edhe për të vetmen arsye se në një trevë të ekspozuar ndikimit grek, siç ka qenë Shqipëria e Jugut, nuk mund të pritej zhvillimi i së ardhmes së tipit *kam për të bërë*, që është një formim i këtyre shekujve të fundit. Edhe më pak i mbrojtshëm është mendimi i Hamp-it (kumtesa cit., 668), sipas të cilit tipi i së ardhmes me «do» në gegërishten veriore duhet konsideruar si një ndikim i të folmeve sllave rreth e rrotull, në të cilat, siç dihet, folja «dua» nuk është as e ngurosur, por zgjedhohet sipas vetës dhe ndiqet jo nga lidhorja, po nga paskajorja e foljes themelore (shih M. Stevanović, Savremeni srpsko-hrvatski jezik, 362). Po të mbahen parasysh kushtet e copëzimit feudal të Shqipërisë gjatë shekujve të Mesjetës dhe kontaktet tepër të kufizuara jugë-veri gjatë pushtimit otoman, është vështirë të mendohet edhe për një përhapje të tipit të së ardhmes me «do» nga të folmet jugore gjer në ato të ekstremit verior të Shqipërisë, dhe të tipit të së ardhmes me ndihmësen «kam» në drejtimin e kundërt.

Në të tilla rrethana, ka më shumë të ngjarë që si tipi i së ardhmes me «do» ashtu edhe ai i së ardhmes me «kam» të jenë formuar në mënyrë të pavarur në gjuhën shqipe gjatë zhvillimit historik të saj, tipi i parë në origjinë si një *futurum voluntatis* dhe i dyti si një *futurum necessitatis*. Në të mirë të këtij mendimi dëshmon tërthorazi edhe fakti i njohur që gjuha shqipe gjatë zhvillimit të saj e ka pasuruar sistemin foljor me një larmi formash foljore, me anë të të cilave shprehen kuptime modale, kohore (temporale) madje dhe aspektive të ndryshme, siç janë format e dëshirores e të habitores, format e tipit *jam duke bërë* me aspekt durativ etj. Të kihet parasysh se në këtë gjuhë me vlerën e një *futurum necessitatis* përdoret edhe ndërtimi i tipit *jam* (në përdorim vetor ose pavetor) + forma e pashtyllë e tipit *për të bërë*, ndërtim ky që është i barazvlershëm për nga kuptimi me gjerundivin latin të shoqëruar me foljen *esse*.

Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia e një ndikimi reciprok midis të folmevet kufitare të shqipes dhe të greqishtes në intensifikimin e përdorimit të së ardhmes së formuar me anë të foljes «dua».

R é s u m é

A PROPOS DES FORMES DU FUTUR EN ALBANAIS

Dans cet article, divisé en deux parties, l'auteur analyse les formes du futur en albanais et la question de leur origine.

Comme on sait, il y a deux types de formes analytiques pour exprimer le futur en albanais: le type avec la particule *do* suivie du subjonctif présent et celui avec l'auxiliaire *kam*. Ce dernier type connaît trois formations: 1) *kam* +

22) Për përdorimin e këtij tipi të së ardhmes në Shqipëri të Mesme shih M. Çeliku, art. cit., «St. fil.» 3, 1968, 130. ku autori ka shprehur mendimin se ky tip futuri «është forma zotëruese në tërë shqipen».

+ l'infinitif du type *me ba*; 2) *kam* + la forme impersonnelle du type *për të bërë* (à valeur d'infinitif); 3) *kam* + subjonctif présent.

Au premier type appartiennent aussi: la forme *do* + subjonctif imparfait (*do të bëja*), employée comme un futur du passé, respectivement comme un conditionnel présent; la forme *do* + subjonctif parfait (*do të kem bërë*), usitée surtout comme un *modus praesumptivus* et très rarement comme un *futurum exactum*, ainsi que la forme *do* + subjonctif plus-que-parfait (*do të kisha bërë*), usitée tant comme un conditionnel passé que comme un *modus praesumptivus* du passé.

Au deuxième type appartiennent aussi les formes du futur du passé, respectivement du conditionnel présent: 1) *kisha me ba*; 2) *kisha për të bërë*; 3) *kisha të bëja*.

L'auteur cite plusieurs sources confirmant que le futur du type *do të bëj* n'est pas usité seulement dans le dialecte tosqe et les parlers des *Arbëresh* (Albanais) d'Italie et de Grèce, mais même dans les parlers du dialecte guègue, y compris ceux de l'extrême nord.

Une forme du deuxième type du futur est connue aussi dans tous les parlers albanais, à la seule exception des parlers des *Arbëresh* de Grèce. Il s'agit ici de la forme du type *kam për të bërë*, qu'on rencontre même dans les parlers guègues. La forme du type *kam me ba* fait défaut aux parlers tosqes, étant donné que l'infinitif du type *me ba* n'y existe pas. Même la forme *kam të bëj* a une extension limitée, étant usitée seulement dans les parlers des *Arbëresh* d'Italie et dans quelques autres parlers d'Albanie.

Dans la première partie de cet article l'auteur souligne aussi le fait connu (v. K. Cipo, *Gramatika shqipe*, pp. 112, 116; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, pp. 198, 210) que, pour exprimer le sens du futur, l'albanais se sert aussi du présent de l'indicatif et du subjonctif. Il met en évidence que le subjonctif présent s'emploie en albanais moderne avec la valeur du futur dans les circonstances suivantes:

I. Lorsqu'il est employé dans des propositions subordonnées, si le verbe de la régente est au présent, parfait ou futur de l'indicatif ou bien au passé simple (indéfinit), précédé de la conjonction subordinative conditionnelle *po*.

II. Lorsqu'il est employé dans des propositions indépendantes avec la valeur du présent de l'impératif, ou bien de l'optatif.

III. Lorsqu'il est employé dans des propositions interrogatives introduites par un pronom ou un adverbe interrogatif, par la particule *a* ou bien sans aucun mot d'interrogation. Dans de tels cas le subjonctif présent est équivalent à l'infinitif français (ou d'une autre langue) précédé d'un verbe modal. P. ex. *Ç'të bëj?* «Que dois-je (puis-je) faire?», *Të shkoj atje?* «Dois-je (puis-je) y aller?».

IV. Lorsqu'il est employé dans des propositions interrogatives-exclamatives du type *Unë të shkoj atje?!* «[Quoi!] Moi [je dois] y aller?».

Chez Buzuku on rencontre assez fréquemment le présent (respectivement l'imparfait) du subjonctif avec la valeur du futur (respectivement du futur du passé ou bien du conditionnel présent). P. ex. *Per pak mot ju të mos më shihni*, e *përapë për pak mot ju të më shihni*. (p. LXVII/bis) «Modicum, et iam non videbitis me: et iterum modicum, et videbitis me ...» (Joannes 16/16).

Pour ce qui concerne cet emploi du subjonctif chez Buzuku, il est bien difficile d'exprimer à présent une opinion définitive, à savoir s'il est question d'une innovation du dialecte auquel Buzuku appartenait, ou bien d'un phénomène conservé depuis une phase antique de l'albanais. Si cette dernière hypothèse serait argumentée, alors l'albanais aussi avec son plus ancien monument écrit donnerait un témoignage de plus en faveur de l'hypothèse connue, selon laquelle les langues indo-européennes se servaient jadis du présent de l'indicatif ou du subjonctif pour exprimer le sens du futur.

*

Dans la deuxième partie du présent article, l'auteur traite de l'origine des formes du futur en albanais. Tout d'abord il fait mention des deux hypothèses contraires (dont les représentants les plus connus sont Sandfeld et Weigand) sur l'origine du futur construit à l'aide de *vouloir* et celui construit à l'aide d'*avoir* dans les langues balkaniques. Ensuite il expose brièvement les opinions de M. La Piana (*Studi linguistici albanesi* I, 151), I. Ajeti («Jeta e Re» 2/1954/122), M. Domi (*Morfologjia historike e shqipes*, 70; *Actes du Ier Congrès international des études balkaniques et sud-est européennes* VI, 672) et J. Gjinari («Studime filologjike» 4/1968/134 sq.), qui affirment qui plus qui moins catégoriquement que tous les deux types du futur en question sont des créations indépendantes de l'albanais.

Ensuite, l'auteur expose les considérations suivantes:

1) On a constaté une tendance générale et relativement ancienne dans les langues indo-européennes de créer des formes analytiques pour exprimer le sens du futur, notamment à l'aide des verbes *vouloir*, *avoir*, *être*, etc.

2) Le futur avec *vouloir* n'est pas un phénomène purement balkanique, comme l'a reconnu Sandfeld aussi. D'autres langues, hors des Balkans, se sont servies aussi de ce type de futur.

3) L'opinion exprimée par certains linguistes dans le passé que le futur formé au moyen de la particule *do* est un phénomène propagé dans le seul dialecte tosqe est privée de fondement. Il s'emploie aussi dans les parlers du guègue, y compris ceux de l'extrême nord. Une trace de ce futur se retrouve même chez Buzuku (1555), d'origine guègue:

A nukë *do të pī* kelqinë qi më ordhënoi Ati? (p. LVIII = 68) «Calicem, quem dedit mihi Pater, non *bibam?*» (Joannes 18/11).

De plus, chez Buzuku on trouve employé, avec la valeur du futur, même le groupe de mots formé par le présent indicatif (Ire et Iie personnes du singulier), suivi du présent subjonctif du verbe principal. Ex.: Hinje se u *duo t u* banj *t u* *bjerë* buka n qiellet... (p. LXIII) «Ecce ego *pluam* vobis panes de caelo» (Exodus 16/4).

L'auteur Demiraj voit dans ce type de construction le noyau du futur avec la particule *do* dans tous les parlers albanais. Il est aussi de l'opinion que ce type de futur doit être assez ancien en albanais.

4) Le type du futur avec *avoir* n'est point un phénomène purement roman, répandu dans les Balkans sous l'influence du latin, comme l'a soutenu Sandfeld et d'autres linguistes. Des traces de ce type de futur sont rencontrées aussi en vieux-slave, vieux-russe, etc.

5) Le type du futur avec *avoir* n'est point répandu seulement dans le dialecte guègue. Il y a des siècles que le tosqe aussi se sert de la construction du type *kam për të bërë* avec la valeur du futur. De plus, on doit tenir compte du fait connu que dans les parlers des *Arbëresh* d'Italie (qui sont très proches des parlers tosqes en ce qui concerne les particularités phonétiques et grammaticales) le futur du type *kam të bëj* est documenté depuis 1592, lorsque fut publiée l'oeuvre de Matranga. Cette forme de futur n'est pas inconnue même dans certains parlers de l'Albanie méridionale.

6) Quant à la question — quel type est plus ancien en albanais, le futur avec l'auxiliaire *avoir* ou bien celui avec la particule *do* — il serait difficile de lui donner une réponse exhaustive à présent. Sandfeld, Ajeti et Gjinari considèrent comme plus ancien le type avec *avoir*, tandis que pour La Piana tous les deux types sont très anciens.

Si l'on tient compte du fait que le futur avec *avoir* est documenté plus tôt

dans l'écriture, alors ce type semble être plus ancien. Mais cet argument n'est pas suffisant, étant donné que les premiers documents écrits du tosqe (exception faite pour les parlers des *Arbëresh* d'Italie) ne dépassent pas le XVIII^e siècle. D'autre part, le fait qu'on ne trouve nulle trace du futur formé à l'aide de *do* chez Matranga (1592), ne signifie point que ce type de futur n'existait pas en ce temps-là dans les parlers des *Arbëresh* d'Italie. Ce type de futur ainsi que celui avec *avoir* (*kam të bëj*), à l'avis de l'auteur de cet article, sont des formes que les *Arbëresh* d'Italie ont reçues en patrimoine de leurs ancêtres émigrés d'Albanie. Donc, la question de la chronologie relative de ces deux types du futur albanais reste ouverte.

Si l'on tient compte des faits linguistiques mentionnés ci-dessus, alors l'hypothèse de Sandfeld que le type du futur avec *vouloir* s'est propagé dans les langues balkaniques sous l'influence du grec, tandis que celui avec *avoir* s'est propagé sous l'influence du latin, reste une hypothèse non argumentée. On ne peut pas exclure a priori la possibilité d'un développement parallèle, surtout pour l'albanais, en invoquant seulement la «supériorité culturelle» du grec ou du latin, quand on sait que les formations de ces types sont engendrées aussi dans plusieurs langues hors des Balkans.

Quant à l'albanais, c'est un fait très significatif que presque tous ses parlers, y compris ceux des *Arbëresh* d'Italie, emploient tous les deux types analysés du futur. Il est vrai que le futur avec *do* (vouloir) prédomine en Albanie méridionale et centrale, tandis que celui avec *kam* (avoir) prédomine en Albanie septentrionale. Mais cette différence dialectale ne doit être expliquée nécessairement par la seule hypothèse sus-mentionnée de Sandfeld, surtout si l'on tient compte du fait que dans une aire exposée à l'influence grecque (comme l'a été l'Albanie méridionale) le futur du type *kam për të bërë* (qui est une formation de ces derniers siècles) n'aurait pas dû avoir lieu.

L'auteur de cet article considère insoutenable aussi l'opinion d'E. Hamp (v. *Actes du Ier Congrès international des Etudes balkaniques et sud-est européennes*, VI, p. 668) que «les cas de *vouloir* dans les constructions du futur en guègue de l'extrême-nord doivent être considérés comme des pénétrations en sens inverse de la part des parlers slaves environnants.»

D'autre part, si l'on tient compte des circonstances du morcellement féodal de l'Albanie au moyen âge ainsi que de la limitation extrême des contacts Sud-Nord pendant la domination ottomane du pays, il est difficile de supposer même une extension du futur avec *do* de la part des parlers méridionaux jusqu'au nord extrême, ou bien du futur avec *kam* dans le sens inverse.

En de telles circonstances il est plus vraisemblable que tous les deux types du futur qu'on vient d'analyser, aient été formés en albanais, de façon indépendante, le type avec *kam* ayant été à l'origine un *futurum necessitatis* et celui avec *do* un *futurum voluntatis*.

Toutefois, on ne peut pas exclure la possibilité d'une influence réciproque entre les parlers limitrophes de l'albanais et du grec en ce qui concerne l'intensification de l'emploi du futur formé à l'aide du verbe *vouloir*.